



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/03/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga av. D.S ndaj gjyqtarit B.A, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 27.03.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ushtruar nga av. D.S ndaj gjyqtarit B.A, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Av. D.S me datë 12 Mars 2024 ka paraqitur ankesë disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës ndaj gjyqtarit B.A, me kërkesë për inicim të procedurës disiplinore. Me datë 18 Mars 2024 në lidhje me pranimin e ankesës është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Parashtruesi i ankesës av. D.S ka deklaruar se me datë 05.03.2024 gjyqtari i Gjykatës themelore në Prishtinë B.A ka kërkuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës një avokat ex officio për një përfaqësim në seancën gjyqësore e cila ishte e caktuar të mbahet me datë 06.03.2024 prej orës 11:30minuta. Sipas tij, atë ditë është njoftuar nga Oda e Avokatëve në lidhje me këtë kërkesë, ku sipas tij ka shkuar në kohën e kërkuar pra në orën 11:30 minuta në Gjykatë dhe punëtorët e sigurimit e kanë udhëzuar që të shkoj në objektin B pasi që nuk e njihnin gjyqtarin B.A, ku pastaj i njëjti ka shkuar në këtë objekt por e ka parë që është gabim pasi që gjyqtari B.A ishte në objektin A në zyrën 109, sipas tij nga kjo neglizhencë të punëtorëve të sigurimit është vonuar 15 minuta dhe kur ka arritur në zyrën e gjyqtari B.A, i njëjti e ka injoruar duke mos dashur fare ta dëgjoj dhe me arrogancë dhe keq sjellje nga pozita e gjyqtarit, ku nuk i është dhënë fare as mundësia të di se kush ishte personi a po i mbrojturi për të cilin ka qenë i caktuar sipas detyrës zyrtare. Ndër të tjerash ka deklaruar se kjo sjellje e gjyqtarit është e papranueshme për çka edhe ka vendosur të paraqesë fletëparaqitje disiplinore për shkak të sjelljeve të pahijshme dhe komunikimit të tij jo korrekt në raport me të si avokat i caktuar sipas detyrës zyrtare, ku i njëjti ka cituar dispozitën e nenit 5 par. 2 në lidhje me pikën 2.2 të Ligjit Nr.06/L-057 mbi Përgjegjësinë disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë që parasheh se shkelje e detyrave të gjyqtarit sipas këtij ligji përfshihen veprimet e gjyqtarit i cili i kryen me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e që kanë të bëjnë me mos trajtim sipas ligjit të palëve në procedurë, përfaqësuesit e tyre, dëshmitarët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë. Sipas tij, gjyqtari B.A

ka shkelur edhe Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë e cila në pikën 5 flet për profesionalizmin dhe përgjegjësinë në punë të gjyqtarit, duke cituar paragrafin 5.6 i cili parasheh se “*gjyqtari ushtron funksionin e tij me durim, dinjitet dhe korrektësi, si ndaj palëve në procedurë po ashtu edhe ndaj personave të tjerë me të cilët ka kontakt profesional dhe një sjellje e tillë kërkohet prej përfaqësuesve ligjo, personelit gjyqësor dhe të tjerëve në mbikëqyrjen e tij*”. Në fund ka deklaruar se ndihet i ofenduar nga sjellja e gjyqtarit B.A andaj ka ushtruar këtë fletëparaqitje disiplinore, për shkak të imazhit dhe kredibilitetit të gjykatës por edhe për shkak të rolit të avokatit si pjesë e sistemit të drejtësisë, duke kërkuar që ndaj gjyqtarit të ndërmerren masa disiplinore.

Në lidhje me pretendimet e paraqitësit të ankesës, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se me datë 06.03.2024 në orën 11:30 ka qenë e caktuar lënda me numër P.nr.2679/19 në çështjen penale ndaj të pandehurës G.J.D, për veprën penale Mashtrim nga neni 323 par. 1 të KPRK-së, në të cilën çështje mbrojtja ka qenë e detyruar. Me datë 05.03.2024 përderisa e pandehura nuk ka pasur të angazhuar mbrojtës dhe mbrojtja ka qenë e detyruar, zyra e gjyqtarit ka thirrur Odën e Avokatëve për caktimin e një avokati sipas detyrës zyrtare për seancën e datës 06.03.2024 në ora 11:30 minuta, me ç rast Oda e ka konfirmuar se do ta caktoj një avokat. Sipas gjyqtarit me datë 06.03.2024 në orën 11:30 minuta ka filluar seanca e shqyrtimit fillestar, në të cilën seancë ka prezantuar vetëm prokurori i shtetit, nuk ka prezantuar as e pandehura edhe pse gjykata ka pasur dëshmi se e njëjta është ftuar në seancë përmes procesverbalit të datës 05.02.2024, nuk ka prezantuar as pala e dëmtuar, edhe pse ka qenë e njoftuar. Sipas tij, në seancë nuk ka prezantuar as avokat i caktuar sipas detyrës zyrtare(për të cilin as nuk ka pasur dijeni se cili është avokat i caktuar sipas detyrës zyrtare dhe as nuk ka marrë konfirmim nga Oda se është caktuar avokati konkret). Gjyqtari ka deklaruar se në mungesë të të pandehurës seanca është shtyrë për datën 23.04.2024 në orën 10:00 dhe procesverbalin për shtyrje e ka nënshkruar Prokurori i Shtetit dhe gjyqtari i çështjes, e cila seancë ka përfunduar në ora 11:40 minuta. Sipas tij, avokati D.S është paraqitur në zyrën e tij në ora 11:55 minuta, i cili ka deklaruar se ka ardhur të prezantoj në seancë pasi që është njoftuar nga Oda e Avokatëve për seancën e datës 06.03.2024, për çka e ka njoftuar se seanca ka përfunduar si dhe e ka njoftuar për rrjedhën e seancës gjyqësore dhe faktin se kush ka qenë prezentë dhe për kur është shtyrë seanca. Tutje gjyqtari ka deklaruar se avokati kërkonte nga gjykata që të konstatoj në proces se edhe avokati ka prezantuar, me pretekstin se i takon kompensimi pavarësisht se nuk ka prezantuar e pandehura, me ç rast gjyqtari i bënë me dije se nuk mundet ta konstatoj në proces një gjë të tillë pasi që i njëjti është me vonesë 25 minuta dhe procesi është nënshkruar nga palët prezentë. Mirëpo, sipas tij, përkundër kësaj avokati ka insistuar që të konstatohet në proces edhe ai dhe i drejtohet gjyqtarit duke deklaruar se “ unë jam qe gjysmë ore poshtë te hyrja, lëshoj kamerat dhe e sheh që kam ardhur në kohë”, ku gjyqtari deklaroi se me mirësjellje i është drejtuar se edhe pse pretendon se ka qenë poshtë te hyrja, nuk ke ardhur në sallë ku je caktuar dhe si rrjedhojë e kësaj përderisa nuk ke prezantuar në kohë dhe vend të caktuar, nuk mund të konstatohet në proces se ke qenë prezentë. Ndër të tjerash, gjyqtari ka deklaruar se pavarësisht kësaj i ka dhënë një kopje të aktakuzës avokatit meqenëse i njëjti ka qenë i caktuar sipas detyrës zyrtare duke i treguar kohën kur është caktuar seanca e radhës. Sipas gjyqtarit, avokati me ironi i është drejtuar me fjalët “ nuk jemi fontan dëshirash këtu”. Pas kësaj, gjyqtari pa arrogancë kërkoi nga avokati që të liroj zyrën e tij, ku më pas i njëjti i është drejtuar se do të paraqes ankesë disiplinore, e më pas gjyqtari i është drejtuar me fjalët “ në rregull dhe mos u ndal,

paraqit ankesë disiplinore, liroma zyrën dhe ditën e mirë”. Deklaratës së tij gjyqtari i ka bashkangjitur edhe procesverbalin e datës 06.03.2024,

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit B.A.

Nuk është kontestues fakti se me datë 06.03.2024 në ora 11:30 në Gjykatën Themelore në Prishtinë ka qenë e caktuar seanca gjyqësore në lëndën P.nr.2679/19 me të pandehur GJ.D, ku po ashtu nuk është kontestuese se në këtë seancë është konstatuar prezenca e vetëm Prokurorit të Shtetit, gjë e cila është vërtetuar përmes procesverbalit të datës 06.03.2024.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës se gjyqtari i çështjes ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 5 paragrafi 2 në lidhje me pikën 2.2 të Ligjit mbi Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, e që kanë të bëjnë me mos trajtimin e palëve sipas legjislacionit në fuqi, Kryetarja e Gjykatës ka gjetur se në rastin konkret gjyqtari i çështjes ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura të cilat parashihen me legjislacionin në fuqi, ku në çdo rast kur ka shtyrje të seancës gjyqësore në mungesë të palëve, një gjë e tillë konstatohet në procesverbal, ku nënshkruhen të gjitha palët prezente. Në rastin konkret, shtyrja nuk ka ardhur si rezultat i mungesës së avokatit por të akuzuarës, ndërsa gjyqtari i çështjes ka përpiluar procesverbal ku konstatohet se seanca ka nisur në ora 11:30 dhe ka përfunduar në ora 11:40, ka konstatuar prezencën e prokurorit të shtetit dhe mungesën e të akuzuarës dhe të dëmtuarës, ndërsa nuk ka konstatuar fare mungesën e avokatit sipas detyrës zyrtare, sepse nuk ka pas asnjë konfirmim se cili avokat do të jetë prezent.

Për përfundimit të seancës së paraparë të mbahet në ora 11:30 dhe e cila për shkak të mungesës së palëve është shtyrë për datë tjetër, nuk kontestohet se në zyrën e gjyqtarit B.A është paraqitur avokati D.S, mirëpo gjyqtari i çështjes në rastin konkret nuk ka qenë i detyruar që të nxjerrë procesverbal të ri për shtyrje të seancës dhe të konstatoj prezencën e avokatit, kur në fakt avokati i caktuar sipas detyrës zyrtare nuk ka qenë prezent në orën e caktuar, për të cilën ka qenë i njoftuar në mënyrë të rregullt.

Për gjyqtarin e çështjes nuk është dhe nuk duhet të jetë e rëndësishme se si shkak i cilës rrethanë avokati i çështjes nuk ka arritur në kohë për mbajtjen e seancës gjyqësore, përjashtimisht në këto raste nëse paraprakisht gjyqtari i çështjes njoftohet për mos prezencën e avokatit me njoftim veçantë ku avokati arsyeton mungesën e tij.

Për Kryetaren e Gjykatës ka mbetur i paqartë pretendimi se gjyqtari i çështjes ka kryer shkelje të cilat parashihen me dispozitat e Ligjit për Procedurën Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë të cilat përcaktojnë *“mos trajtimin e palëve siç kërkohet me ligj nga ana e gjyqtarit a po shkeljen e Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtarë, i cili parasheh ushtrimin e funksionit të gjyqtarit me durim, me dinjitet dhe korrektësi, si ndaj palëve në procedurë po ashtu edhe ndaj personave të tjerë me të cilët ka kontakt profesional”*, kjo sepse nga ankesa e dorëzuar por as nga deklarata e gjyqtarit nuk kemi arritur të konstatojmë se gjyqtari ka trajtuar palët pa dinjitet, pa korrektësi a po pa durim, kur në fakt i njëjti ka deklaruar se pavarësisht vonesës së avokatit për pjesëmarrje në seancë, që edhe po të ishte prezentë seanca nuk do të ishte mbajtur pasi që mungonte e akuzuara, të njëjtit i është dhënë një kopje e aktakuzës si dhe është njoftuar për

datën e ardhshme kur është caktuar të mbahet seanca, në mënyrë që të mos kërkoj avokat tjetër sipas detyrës zyrtare.

Andaj, nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk janë shkelur dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/03/24, me datë 27.03.2024

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë